



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.237/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazic dhe Zyhdi Haziri anëtar, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, pasi që lidhur me këto pretendime është vendosur me vendimin ZL.Anr.220/2017 të datës 16.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 17.10.2017, nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me të cilën ka theksuar se në spotin politik të shpërndarë përmes rrjetit social facebook, nga subjekti politik PDK, ka dyshim të bazuar për shkelje të rregullave zgjedhore. Më tej ka pretenduar në ankesë se në spotin e publikuar nga PDK-ja, shihet kandidati për kryetar të Komunës së Malishevës Z. Kadri Veseli, duke bërë thirrje tek qytetarët e Komunës së Malishevës për ta votuar kandidatin për kryetar të kësaj komune nga radhët e PDK-së, në afërsi të të cilëve ndodhet edhe një fëmijë. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 5 pika 2 e Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka ofruar një CD dhe një fotografi të printuar, lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në përgjigjen në ankesë të datës 18.10.2017, ka theksuar se pretendimet në ankesë janë të pa baza dhe se ankesa është bërë dy herë për të njëjtën çështje. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ankesa ZL.Anr.237/2017 është e njëjtë me ankesën ZL.Anr.220/2017 të datës 13.10.2017.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se:

Ankesa është e pa lejuar

Meqenëse për të njëjtën çështje është vendosur me vendimin e PZAP-së, ZL.Anr.220/2017 të datës 16.10.2017, Paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, rezulton se kjo çështje në fjalë është çështje e gjykuar (res iudicata).

Paneli në kuptim të nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 237/2017 më datën 20.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.